



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Nr.83  
Str: Radovan Zogovic  
10 000 Prishtina

# RREGULLORE PËR REGJISTRIM DHE KALIM E FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Prishtinë, 2024



## PËRMBAJTJA

<b>I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME .....</b>	<b>4</b>
NENI 1 - QËLLIMI.....	4
NENI 2 - ORGANI I SHKALLËS SË PARË.....	4
NENI 3 - PËRKUFIZIMET.....	5
<b>II. REGJISTRIMI DHE EVIDENCA E KLUBEVE.....</b>	<b>6</b>
NENI 4 - KËRKESA PËR REGJISTRIM .....	6
NENI 5 - VENDIMI PËR REGJISTRIM .....	6
NENI 6 - NJOFTIMI PËR NDRYSHIME.....	7
NENI 7 - P.JESËMARRJA NË GARA.....	7
NENI 8 - NDËRRIMET STATUTARE TË EKIPEVE.....	7
NENI 9 - SHUARJA E ANËTARËSISË.....	7
NENI 10 - FSHIRJA NGA ANËTARËSIA.....	8
NENI 11 - REGJISTRI I KLUBEVE ANËTARE TË FBK-SË .....	8
<b>III. REGJISTRIMI I LOJTARËVE-EVE .....</b>	<b>8</b>
NENI 12 - PARIMET THEMELORE.....	8
NENI 13 - REGJISTRIMI .....	10
NENI 14 - KËRKESA PËR REGJISTRIM TË LOJTARËVE .....	11
NENI 15 - PROCEDURA PËR REGJISTRIMIN E LOJTARIT NDËRKOMBËTAR (TË HUAJ).....	16
NENI 16 - REGJISTRIMI I LOJTARËVE NGA FBK .....	16
NENI 17 - EVIDENCA E LOJTARËVE TË REGJISTRUAR .....	16
NENI 18 - LICENCA E REGJISTRIMIT .....	17
<b>IV. MARRËVESHJA/KONTRATA .....</b>	<b>17</b>
NENI 19 - PËRMBAJTJA DHE NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES NDËRMJET KLUBIT DHE LOJTARIT/ES .....	17
NENI 20 - LLOJET E MARRËVESHJEVE.....	18
1. MARRËVESHJE PËR STËRVITJE DHE PARAQITJE (deri 14 vjeç).....	18
2. MARRËVESHJA PËR AFTËSIM SPORTIV (14-18 vjeç).....	19
3. MARRËVESHJA E PARË PËR SENIORË.....	19
4. MARRËVESHJA PËR SENIORË (më të vjetër se 22 vjet).....	20
NENI 21 - PËRJASHTIMET NË PERIUdhËN KOHORE TË MARRËVESHJES.....	20
NENI 22 - NDËRPRERJA/SHKËPUTJA E MARRËVESHJES .....	20
<b>V. KALIMI PREJ EKIPI NË EKIP .....</b>	<b>21</b>
NENI 23 - AFATET PËR KALIM.....	21
NENI 24 - DISPOZITA TJERA RRETH KALIMIT PREJ EKIPI NË EKIP .....	22
NENI 25 - E DREJTA E KALIMIT .....	23
<b>VI. FUZIONIMI (BASHKIMI) I EKIPEVE .....</b>	<b>25</b>
NENI 26 - FUZIONIMI.....	25
<b>VII. PARAQITJA JASHTË SHTETIT .....</b>	<b>26</b>
NENI 27 - E DREJTA E PARAQITJES JASHTË SHTETIT .....	26
NENI 28 - KËRKESA .....	26
NENI 29 - TRANSFERI NDËRKOMBËTAR I LOJTARËVE NËN 18 VJEÇ .....	27
<b>VIII. KTHIMI I LOJTARIT NGA JASHTË .....</b>	<b>27</b>
NENI 30 - KTHIMI I LOJTARIT VENDOR NË KLUB VENDAS .....	27



<b>IX. PARAQITJA E LOJTARËVE NDËRKOMBËTARË (TË HUAJ) .....</b>	<b>28</b>
NENI 31 – PARAQITJA E LOJTARËVE TË HUAJ.....	28
NENI 32 – LOJTARI I NATYRALIZUAR.....	28
<b>X. PARAQITJA E LOJTARËVE .....</b>	<b>29</b>
NENI 33 – E DREJTA E PARAQITJES NË NDESHJE .....	29
NENI 34 – LICENCA E DYFISHTË .....	29
NENI 35 – PARAQITJA PËR KLUB TJETËR .....	30
NENI 36 – HUAZIMI I LOJTARËVE .....	30
<b>XI. REGJISTRIMI DHE LICENCIMI I TRAJNERËVE .....</b>	<b>30</b>
NENI 37.....	30
<b>XII. E DREJTA PËR ANKESË DHE KËRKESA PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË .....</b>	<b>31</b>
NENI 38.....	31
<b>XIII. DORËZIMI .....</b>	<b>32</b>
NENI 39.....	32
<b>XIV. AFATET .....</b>	<b>33</b>
NENI 40.....	33
<b>XV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALUESE.....</b>	<b>33</b>
NENI 41.....	33



Në bazë të nenit 23, alineja 1.17 të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i FBK-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 09.08.2024, miratoi këtë:

## RREGULLORE PËR REGJISTRIM DHE KALIM E FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### NENI 1 - Qëllimi

- Me këtë Rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat për:
  - Regjistrimin e klubeve;
  - Regjistrimin e lojtarëve-eve;
  - Marrëveshjet/Kontratat;
  - Kalimin e lojtarëve-eve prej një skuadre në një tjetër skuadër;
  - Fuzionimin (bashkimin) dhe ndarjen e klubeve;
  - Pjesëmarrjen e lojtarëve vendorë në skuadra ndërkombëtare;
  - Regjistrimin dhe paraqitjen e lojtarëve të kthyer nga jashtë;
  - Regjistrimin e lojtarëve ndërkombëtarë (të huaj) në Republikën e Kosovës;
  - Huazimin e lojtarëve/eve;
  - Të drejtën e pjesëmarrjes së lojtarëve për ekipe në ligat e FBK-së; dhe
  - Licencimin e trajnerëve të basketbollit.

#### NENI 2 - Organi i shkallës së parë

Komisioni i Garave i Federatës së Basketbollit të Kosovës, në pajtim me këtë Rregullore, sipas procedurave të cekura në nenin 1 vendos si organ i shkallës së parë.



## NENI 3 - Përkufizimet

**1.** Termet dhe shprehjet e përdorura në këtë rregullore do të interpretohen për të përfshirë të gjitha gjinitë, dhe asnjë dispozitë nuk do të interpretohet si specifike për gjininë përveç nëse shprehet qartë ndryshe.

### **2. Lojtari/ja - anëtar/e i/e regjistruar i klubit;**

**a.** Termi **lojtar profesionist** do të thotë një lojtar i regjistruar i cili ka një kontratë profesionale për zhvillimin e veprimtarisë sportive, profesioni kryesor i të cilit është të luajë basketboll dhe i cili është i siguruar detyrimisht mbi këtë bazë në përputhje me rregullore të veçanta.

**b.** Të gjithë lojtarët e tjerë kanë **status amator**.

**3. Lojtar i huaj** - lojtar që nuk ka shtetësinë e Republikës së Kosovës në momentin e regjistrimit në FBK;

**4. Lojtar i lirë (free agent)** - lojtar të cilit i ka përfunduar kontrata me ekipin e tij të mëparshëm (nuk ka kontratë aktive/valide) dhe është i lirë të nënshkruajë një kontratë të re me cilindo ekip tjetër. Një lojtar i lirë ka të drejtë të negociojë dhe të pranojë oferta nga ekipet e tjera pa kufizime të vendosura nga ekipi i tij i mëparshëm.

**5. Regjistrimi** - regjistrim në regjistrat e FBK-së për klube apo lojtarë (regjistrohu.com), të regjistruar në bazë të aplikimit të paraqitur dhe dokumentacionit të bashkangjitur;

**a.** Për lojtarë nënkupton regjistrimin e parë të një lojtari për një klub, kalimin e një lojtari nga një klub në një klub, kalimin e një lojtari që nuk ka pasaportë kosovare nga një klub i huaj ose vendas në një klubi vendas dhe kalimi i një lojtari kosovar nga një klub i huaj në një klub vendas.

**6. Huazimi i lojtarëve** - instrument që lejon një lojtar të marrë të drejtën për të luajtur për ekipin e një klubi tjetër për një kohë të caktuar.



## II. REGJISTRIMI DHE EVIDENCA E KLUBEVE

### NENI 4 - Kërkesa për regjistrim

- 1.** Ekipi i cili shpreh dëshirën që të bëhet anëtar i FBK-së, kërkesën për regjistrim ia paraqet Komisionit të Garave, kërkesë e cila duhet miratuar përkohësisht nga Bordi i FBK-së deri në pranimin përfundimtar të anëtarëve të rinj në Kuvendin e Federatës në mbledhjen e radhës, me më tepër se 50% të votave të delegatëve të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit.
- 2.** Ekipi i cili e paraqet kërkesën është i obliguar të mbush formularin për regjistrim dhe të njëjtën ta përcjell tek Komisioni i Garave. Kërkesa duhet të jetë e firmosur nga personi i autorizuar dhe e vulosur me vulën e Subjektit.
- 3.** Me paraqitjen e kërkesës për regjistrim në FBK, klubi obligohet që të respektojë Statutin, Rregulloret dhe aktet tjera normative të organeve dhe organizatave të Federatës së Basketbollit të Kosovës, FIBA Europe, FIBA, WADA dhe Komitetit Olimpik Ndërkombëtar;
- 4.** Klubet janë materialisht dhe penalisht përgjegjës për saktësinë e të dhënave që paraqesin pranë organeve të FBK-së.

### NENI 5 - Vendimi për regjistrim

- 1.** Komisioni i Garave është i obliguar që në afat prej shtatë (7) ditësh pas pranimit të kërkesës për regjistrim, të shqyrtojë të njëjtën dhe 24 orë para skadimit të marrë vendim për regjistrimin e ekipit si anëtar të FBK-së.
- 2.** Pas shqyrtimit të kërkesës, Komisioni i Garave e përcjell aplikim tek Bordi për miratim të përkohshëm, deri në pranimin përfundimtar të anëtarëve të rinj në Kuvendin e Federatës në mbledhjen e radhës, me më tepër se 50% të votave të delegatëve të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit.
- 3.** Aktvendimi për regjistrim i dorëzohet ekipit, i cili regjistrohet si anëtar i FBK-së në regjistrin përkatës.
- 4.** Nëse kërkesa për regjistrim nuk i përmban të gjitha parakushtet e cekura në këtë nen, nuk është i bashkangjitur aktvendimi regjistrimit në Qendrën regjistruese dhe nuk është firmosur dhe vulosur me vulë, Komisioni i Garave



24 orë para skadimit të afatit për paraqitje në garat e FBK-së do të marrë aktvendim për refuzimin e kërkesës si e parregullt.

## **NENI 6 - Njoftimi për ndryshime**

1. Çdo klub anëtar i FBK duhet të njoftojë zyrën ekzekutive të FBK-së brenda 15 ditëve nga pranimi i ndryshimeve në lidhje me dokumentacionin e klubit.
2. Të gjitha ndryshimet futen në regjistrin bazë të anëtarëve.

## **NENI 7 - Pjesëmarrja në gara**

1. Pas regjistrimit të klubit në FBK, i njëjti është i obliguar që të kyçet në fillim të garave të edicionit të ri dhe organi i autorizuar i FBK-së është i obliguar që t'ia mundësojë.
2. Nëse ekipi nuk kyçet nga fillimi i edicionit në ndeshjen e parë, Komisioni i Garave i FBK-së sipas detyrës zyrtare do të marrë aktvendim mbi fshirjen e ekipit nga anëtarësimi në FBK.

## **NENI 8 - Ndërrimet statutare të ekipeve**

1. Në rast të ndërrimeve statutare të ekipeve në institucionet e Republikës së Kosovës, apo në rast të së drejtës për të garuar në nivel të caktuar të garave, si dhe në rastin e fuzionimit (bashkimit) të dy apo më tepër skuadrave, Komisioni i Garave në kërkesë të ekipeve do të lëshon pëlqimin në formë të shkruar, vetëm atëherë nëse kërkesës i bashkëngjiten deklaratat për marrjen e të gjitha të drejtave dhe obligimeve nga ekipet të cilat kërkojnë pëlqimin apo marrëveshjet reciproke se cili ekip do t'i marrë mbi sipër të drejtat për garim dhe detyrimet.
2. Deklarata dhe marrëveshja e detyrimeve duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga personat e autorizuar të të gjitha ekipeve të cekura në deklaratë apo marrëveshje.

## **NENI 9 - Shuarja e anëtarësisë**

1. Anëtarësimi i klubeve në FBK pushon me:
  - 1.1. Pushimin e ekipit si person juridik;
  - 1.2. Daljen me dëshirë të ekipit nga anëtarësimi në FBK me dorëzimin e deklaratës për çregjistrim nga anëtarësimi;



**1.3.** Ndalesën për kryerjen e veprimtarisë nga ana e organit të autorizuar shtetëror;

**1.4.** Vendimin e Bordit të FBK-së, nëse ekipi vepron në kundërshtim me Statutin dhe aktet normative të FBK-së;

**1.5.** Vendimin e Komisionit të Garave apo komisioneve tjera të FBK-së nëse klubi edhe pas një vërejtjeje të dhënë me shkrim edhe më tej vepron në kundërshtim me Statutin dhe aktet tjera normative të FBK-së;

**1.6.** Mospjesëmarrjen e ekipit në garat e FBK-së në dy edicionet e fundit të garave.

### **NENI 10 - Fshirja nga anëtarësia**

**1.** Në rast të ekzistimit të një prej shkaqeve të cekura në nenin 9 të kësaj Rregulloreje, Komisioni i Garave, në afat prej 30 ditësh nga dita e ndodhjes së shkakut, sipas detyrës zyrtare duhet të marrë aktvendim për fshirjen e ekipit nga anëtarësimi në FBK.

**2.** Komisioni i Garave i FBK-së, aktvendimin nga pika 10.1 ia dorëzon ekipit, Bordit të FBK-së dhe Sekretarit të Përgjithshëm të FBK-së.

### **NENI 11 - Regjistri i klubeve anëtare të FBK-së**

Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së nëpërmjet shërbimit administrativ udhëheq regjistrin e ekipeve anëtare të FBK-së dhe për çdo ekip udhëheq dosjen me dokumentacionin e tërësishëm nga momenti i regjistrimit të ekipit.

## **III. REGJISTRIMI I LOJTARËVE-EVE**

### **NENI 12 - Parimet themelore**

**1.** Të drejtat dhe obligimet gjatë regjistrimit, kalimit dhe paraqitjes së lojtarëve rregullohen në bazë të këtyre parimeve:

**1.1.** Lojtari-ja zgjedh me dëshirë ekipin për të cilin do të paraqitet;





- 1.2.** Lojtari-ja mund të regjistrohet vetëm me një klub, me përjashtim të rasteve ku lojtari njëkohësisht regjistrohet edhe për një klub në basketbollin 3x3;
- 1.3.** Marrëdhëniet në mes të lojtarit-es dhe ekipit rregullohen me Marrëveshjen e lidhur në mes të lojtarit-es dhe ekipit;
- 1.4.** Gjatë nënshkrimit të marrëveshjes në mes të lojtarit-es dhe ekipit, obligim i ekipit është që ta njoftojë lojtarin me Statutin dhe aktet normative të FBK-së, si dhe me aktet dhe rregulloret e ekipit;
- 1.5.** Kur regjistrohet dhe dorëzohet një kërkesë për kalim ose huazim për një lojtar nën moshën 16 vjeç, kërkohet pëlqimi i prindit ose përfaqësuesit ligjor;
- 1.6.** Paraqitja e lojtarëve jashtë vendit dhe paraqitja e lojtarëve ndërkombëtarë (të huaj) në garat e FBK-së mund të kufizohet për t'u mbrojtur interesi i basketbollit kosovar;
- 1.7.** Të gjitha të drejtat tjera rregullohen me këtë Rregullore dhe aktet e përgjithshme normative të FBK-së, kurse dispozitat e marrëveshjes nuk guxojnë të jenë në kundërshtim me këtë Rregullore;
- 1.8.** Gjatë regjistrimit të lojtarëve të të gjitha moshave, duhet të dorëzohet certifikata mjekësore e gjendjes shëndetësore të lojtarit dhe atë dy herë brenda një edicionit, para fillimit të pjesës së parë të edicionit garues dhe para fillimit të pjesës së dytë të garave në të cilin merr pjesë lojtari;
- 1.9.** Në ndeshje mund të paraqiten vetëm lojtarët-et të cilët (cilat) kanë kartelën garuese-licencën MAP (të regjistruar në platformën regjistruhu.club) e lëshuar dhe vërtetuar nga ana e organit të autorizuar nga FBK, me kusht që lojtari-ja të ketë përmbushur të gjitha obligimet tjera dhe të mos jetë i/e suspenduar apo në vuajtje të dënimit.



## NENI 13 - Regjistrimi

- 1.** Lojtari me dëshirë e zgjedh ekipin për të cilin do të paraqitet dhe me ekipin e nënshkruan Marrëveshjen në të cilën e shpreh vullnetin e lirë për t'u regjistruar dhe paraqitur për ekipin, deklaron që do t'i pranojë aktet normative të ekipit, FBK-së, institucionit përkatës shtetëror, FIBA Evropa, FIBA, WADA dhe KosADA dhe Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe do të zotohet se do të respektojë principet e kodeksit të përgjithshëm sportiv.
- 2.** Lojtari mund të regjistrohet më së shumti për dy (2) ekipe gjatë një edicioni garues.
- 3.** Lojtari-ja i cili nënshkruan marrëveshje me dy apo më tepër ekipe gjatë një afati kalimtar, do t'i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore dhe mbetet anëtar i ekipit me të cilin ka nënshkruar marrëveshjen.
- 4.** Lojtari i cili ka marrëveshje valide dhe nënshkruan marrëveshje me ekip tjetër në afatin tjetër kalimtar, do të suspendohet dhe i njëjti nuk ka të drejtë paraqitjeje derisa të përcaktohet përgjegjësi disiplinore. Lojtari i tillë mbetet anëtar i ekipit me të cilin ka marrëveshje valide, kurse marrëveshja e nënshkruar me ekipin tjetër është e pavlefshme.
- 5.** Lojtari i cili regjistrohet në FBK, prej atij momenti nuk ka të drejtë të paraqitet për klubin paraprak (ose ndonjë klub tjetër) në ndeshje zyrtare. Kjo vlen posaçërisht për afatet kalimtare dhe afatit kalimtar për lojtarë të huaj para fillimit të xhiros së XXII-të. Çdo paraqitje për klub tjetër pas regjistrimit në FBK do të rezultojë automatikisht me anulimin e regjistrimit të atij lojtari në FBK.
- 6.** Lojtari i lirë (free agent) i cili nuk ka kontratë aktive/valide me asnjë klub basketbolli në momentin e përfundimit të afatit kalimtar, mund të regjistrohet jashtë afatit kalimtar vetëm në rastet e mëposhtme:
  - 6.1.** Dëmtimi i një lojtari të ekipit aktual që pritet të zgjasë për një periudhë më të gjatë se dy muaj;
  - 6.2.** Largimi ose pezullimi i një lojtari të ekipit për një periudhë më të gjatë se dy muaj për arsye disiplinore ose personale;
  - 6.3.** Situata të tjera të jashtëzakonshme të cilat pengojnë ekipin nga pjesëmarrja konkurruese e rregullt, të aprovuara paraprakisht nga Komisioni i Garave.



**6.4.** Përrjashtimisht, sipas vlerësimit të Komisionit të Garave, do konsiderohet lejimi i regjistrimit të lojtarit të lirë jashtë afatit kalimtar nëse kjo është në interes të basketbollit kosovar / përfaqësimit kombëtar.

## **NENI 14 - Kërkesa për regjistrim të lojtarëve**

**1.** Çdo ekip është i obliguar që në afatin e caktuar t'ia dorëzojë Komisionit të Garave listën e lojtarëve të cilët do të paraqiten për ekip.

**2.** Taksat/tarifat për regjistrimin e lojtarëve gjatë afatit kalimtar janë si në vijim:

**2.1.** Superliga Meshkujt: 100 EUR;

**2.2.** Superliga Femrat: 50 EUR;

**2.3.** Liga e Parë Meshkujt: 50 EUR;

**2.4.** Liga e Dytë Meshkujt: 50 EUR.

**3.** Taksat/tarifat për regjistrimin e lojtarëve jashtë afatit kalimtar dyfishohen (dyfishi i taksave të specifikuara në paragrafin 2 të këtij neni).

**4.** Gjatë paraqitjes ekipi duhet të bashkëngjisë kërkesës:

**4.1. Për regjistrimin e parë lojtarët-et deri në moshën 14 vjeçare (i dedikohet lojtarëve të cilët për herë të parë regjistrohen në regjistrin e lojtarëve në FBK dhe regjistrimi i tyre bëhet gjatë tërë vitit):**

**4.1.1.** Marrëveshjen për stërvitje dhe paraqitje, e lidhur në mes të ekipit dhe prindit (kujdestarit) të lojtarit (për lojtarët deri në moshën 14 vjeçare);

**4.1.2.** Certifikatën mjekësore për kontrollimin e kryer mjekësor të lojtarit të lëshuar nga ana e entit të autorizuar për mjekësinë sportive (jo më të vjetër se një muaj);

**4.1.3.** Fotokopjen e pasaportës valide;

**4.1.4.** Një fotografi 3 x 2,5 cm jo më të vjetër se një(1) muaj dhe një tjetër e dërguar në mënyrë elektronike te Komesari i Garave i Kategorive të Reja në FBK;



**4.1.5.** Dëshminë mbi pagesën e taksës në lartësi të cilën e vendosë Bordi i FBK-së për regjistrim dhe licencim të lojtarit-es.

**4.1.6.** Deklaratën-pajtimin që FBK mund të bëjë përpunimin e shënimeve personale të lojtarit dhe të shërbehet për nevoja të FBK-së.

## **4.2. Për regjistrimin e lojtarëve-eve nga moshë 15 deri në 18 vjeçare:**

**4.2.1.** Marrëveshjen për aftësim profesional të lidhur në mes të ekipit dhe prindit (kujdestarit) të lojtarit-es;

**4.2.2.** Certifikatën mjekësore për kontrollimin e kryer mjekësor të lojtarit të lëshuar nga ana e entit të autorizuar për mjekësinë sportive (jo më të vjetër se një muaj);

**4.2.3.** Fotokopjen e pasaportës valide;

**4.2.4.** Një fotografi 3 x 2,5 cm jo më të vjetër se tre (3) muaj dhe një tjetër e dërguar në mënyrë elektronike te Komesari i Garave të Kategorive të Reja në FBK;

**4.2.5.** Dëshminë mbi pagesën e taksës në lartësi të cilën e vendos Bordi i FBK-së për regjistrim dhe licencim të lojtarit-es.

**4.2.6.** Deklaratën-pajtimin që FBK mund të bëjë përpunimin e shënimeve personale të lojtarit dhe të shërbehet për nevoja të FBK-së.

## **4.3. Për regjistrimin e lojtarëve/eve mbi moshën 18 vjeçare:**

**4.3.1.** Marrëveshjen e lidhur në mes të lojtarit-es dhe ekipit.

**4.3.2.** Certifikatën mjekësore për kontrollimin e kryer mjekësor të lojtarit të lëshuar nga ana e entit të autorizuar për mjekësinë sportive;

**4.3.3.** Fotokopjen e pasaportës valide;



**4.3.4.** Një fotografi 3 x 2,5 cm jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj dhe një tjetër e dërguar në mënyrë elektronike te Komisioni i Garave.

**4.3.5.** Dëshminë mbi pagesën e taksës në lartësi të cilën e vendos Bordi i FBKsë për regjistrim dhe licencim të lojtarit-es;

**4.3.6.** Deklaratën-pajtimin që FBK mund të bëjë përpunimin e shënimeve personale të lojtarit dhe të shërbehet për nevoja të FBK-së.

#### **4.4. Për regjistrimin e lojtarëve të cilët kalojnë prej një skuadre në skuadrën tjetër:**

**4.4.1.** Marrëveshjen e lojtarit-es me ekipin e mëparshëm, afati i së cilës ka skaduar apo pëlqimin mbi ndërprerjen e ndër-sjell të Marrëveshjes me ekipin e mëparshëm apo vendimin e plotfuqishëm për ndërprerjen e Marrëveshjes të marr nga Komisioni i Garave;

**4.4.2.** Marrëveshjen e lidhur në mes të lojtarit dhe ekipit në të cilin kalon;

**4.4.3.** Certifikatën mjekësore për kontrollimin e kryer mjekësor të lojtarit të lëshuar nga ana e entit të autorizuar për mjekësinë sportive;

**4.4.4.** Një fotografi 3 x 2,5 cm jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj dhe një tjetër e dërguar në mënyrë elektronike te Komisioni i Garave;

**4.4.5.** Dëshminë mbi pagesën e taksës në lartësi të cilën e vendos Bordi i FBKsë për regjistrim dhe licencim të lojtarit-es;

**4.4.6.** Deklaratën-pajtimin që FBK mund të bëjë përpunimin e shënimeve personale të lojtarit dhe të shërbehet për nevoja të FBK-së.



#### **4.5. Për regjistrimin e lojtarëve vendorë të cilët kthehen nga jashtë:**

**4.5.1.** Fletë lëshimin-Certifikatën (LETTER OF CLEARANCE LOC) nga Federata Nacionale në të cilën lojtari është paraqitur për herë të fundit, gjegjësisht ka qenë i licencuar për paraqitje;

**4.5.2.** Marrëveshjen në mes të lojtarit dhe ekipit në të cilin kalon;

**4.5.3.** Certifikatën mjekësore për kontrollimin e kryer mjekësor të lojtarit të lëshuar nga ana e entit të autorizuar për mjekësinë sportive;

**4.5.4.** Një fotografi 3 x 2,5 cm jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj dhe një tjetër e dërguar në mënyrë elektronike te Komisioni i Garave;

**4.5.5.** Dëshminë mbi pagesën e taksës në lartësi të cilën e vendos Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës për regjistrim dhe licencim të lojtarit-es.

**4.5.6.** Deklaratën-pajtimin që FBK mund të bëjë përpunimin e shënimeve personale të lojtarit dhe të shërbehet për nevoja të FBK-së.

#### **4.6. Për regjistrimin e lojtarëve të huaj për klubet e Republikës së Kosovës:**

**4.6.1.** Marrëveshjen në mes të lojtarit dhe ekipit;

**4.6.2.** Fotokopja e pasaportës së lojtarit;

**4.6.3.** Një fotografi 3 x 2,5 cm jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj dhe një tjetër e dërguar në mënyrë elektronike te Komisioni i Garave;

**4.6.4.** Certifikatën mjekësore për kontrollimin e kryer mjekësor të lojtarit, të lëshuar nga ana e entit të autorizuar mjekësor;

**4.6.5.** Fletë lëshimin-Certifikatën (LETTER OF CLEARANCE) nga Federata Nacionale në të cilën lojtari është paraqit për herë të fundit;



**4.6.6.** Dëshminë mbi pagesën e taksës në lartësi të cilën e vendos Bordi i FBKsë për regjistrim dhe licencim të lojtarit-es.

**4.6.7.** Deklaratën-pajtimin që FBK mund të bëjë përpunimin e shënimeve personale të lojtarit dhe të shërbehet për nevoja të FBK-së.

#### **4.7. Për regjistrimin e lojtarëve të lirë (free agent) jashtë afatit kalimtar:**

**4.7.1.** Klubi që kërkon të regjistrojë një lojtar të lirë jashtë afatit kalimtar duhet të dorëzojë një kërkesë zyrtare pranë Komisionit të Garave. Kërkesa duhet të përmbajë:

- (a)** Emrin dhe të dhënat personale të lojtarit të lirë;
- (b)** Arsyen për regjistrimin e lojtarit jashtë afatit kalimtar, përfshirë dokumentacionin përkatës (raporte mjekësore, vendime disiplinore, etj.);
- (c)** Kontratën e propozuar ndërmjet klubit dhe lojtarit të lirë;
- (d)** Dëshminë mbi pagesën e taksës në lartësi të cilën e vendos Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës për regjistrim dhe licencim të lojtarit-es;
- (e)** Deklaratën-pajtimin që FBK mund të bëjë përpunimin e shënimeve personale të lojtarit dhe të shërbehet për nevoja të FBK-së.

**4.7.2.** Komisioni i Garave duhet të shqyrtojë kërkesën brenda një periudhe prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të kërkesës.

**4.7.3.** Çdo klub ka të drejtë të regjistrojë vetëm një lojtar të lirë jashtë afatit kalimtar gjatë një sezoni të caktuar, përveç rasteve kur ka më shumë se një lojtar të dëmtuar apo larguar, dhe vetëm me miratimin e Komisionit të Garave.

**4.7.4.** Regjistrimi i lojtarëve të lirë jashtë afatit kalimtar nuk është i vlefshëm për periudhën e play-off ose finaleve të kampionatit, përveç nëse lojtari që zëvendësohet është dëmtuar brenda periudhës së play-off ose finaleve.



## **NENI 15 - Procedura për regjistrimin e lojtarit ndërkombëtar (të huaj)**

- 1.** Çdo ekip i cili ka të drejtë të regjistrojë lojtarë ndërkombëtarë (të huaj), së bashku me kërkesën për regjistrim është i obliguar që të dorëzojë dokumentacionin komplet më së voni 48 orë para ndeshjes kampionale apo të Kupës.
- 2.** Procedura për sigurimin e Fletë lëshimit (LOC) bëhet nëpërmjet MAP -it të FIBA-s dhe FIBA Evropa në harmoni me rregullat dhe afatet e përcaktuara.
- 3.** Lojtari fiton të drejtën për paraqitje në ndeshje pas lëshimit të LOC-ut nga FIBA MAP dhe pas njoftimit të klubit nga FBK rreth kësaj.

## **NENI 16 - Regjistrimi i lojtarëve nga FBK**

- 1.** Regjistrimi i lojtarëve bëhet përmes platformës regjistrohu.club.
- 2.** Të gjitha vendimet për lojtarët e regjistruar dhe ata të paregjistruar do të publikohen në faqen zyrtare të FBK-së.
- 3.** Regjistrimi dhe paraqitja e lojtarit është i lejuar pas vendimit të plotfuqishëm të Komisionit të Garave.

## **NENI 17 - Evidenca e lojtarëve të regjistruar**

- 1.** Komisioni i Garave (nëpërmjet shërbimit administrativ) mban evidencën e regjistrimit të lojtarëve me këto të dhëna:
  - 1.1.** Numrin rendor të regjistrimit;
  - 1.2.** Data e regjistrimit;
  - 1.3.** Emri dhe mbiemri i lojtarit-es;
  - 1.4.** Data dhe vendi i lindjes së lojtarit-es;
  - 1.5.** Numri personal i lojtarit-es dhe numri i pasaportës;
  - 1.6.** Adresa e vendbanimit të lojtarit-es;
  - 1.7.** Emri i ekipit për të cilin regjistrohet lojtari.
- 2.** Përveç të dhënave të detyrueshme nga paragrafi 1 i këtij neni, të dhëna të tjera për lojtarin e regjistruar mund të futen për nevojat e përfaqësueseve të Kosovës, si gjatësia e lojtarit, numri i fanellës, numri i këpucëve dhe të dhëna të ngjashme.





## NENI 18 - Licenca e regjistrimit

1. Për çdo lojtar-e të regjistruar, Komisioni i Garave lëshon numrin identifikues të licencës.
2. Licenca lëshohet në kohëzgjatje të përcaktuar.
3. Përmbajtjen dhe lartësinë e taksës për lëshimin e licencës e përcakton Bordi i FBK-së.

## IV. MARRËVESHJA/KONTRATA

### Neni 19 - Përmbajtja dhe nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet klubit dhe lojtarit/es

1. Të drejtat dhe obligimet reciproke të lojtarit dhe ekipit përcaktohen me Marrëveshje.
2. Të gjitha marrëveshjet evidentohen në FBK.
3. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në së paku tri (3) kopje prej të cilave secila palë e mban nga një kopje dhe një (1) kopje mbetet në FBK.
4. **Në veçanti, kontrata duhet të përmbajë dispozita në lidhje me:**
  - 4.1. **kohëzgjatjen e kontratës**, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se katër sezona konkurruese, si dhe kushtet për rinovimin ose përfundimin e kontratës;
  - 4.2. **detyrimet financiare** - paga e lojtarit dhe struktura e pagesave (p.sh., mujore, javore) si dhe përfitime të tjera (p.sh., bonuse për arritje në gara të ndryshme, etj.);
  - 4.3. **detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve kontraktuese** - detyrimet dhe përgjegjësitë e lojtarit (p.sh., pjesëmarrja në ndeshje dhe stërvitje, sjellja profesionale, kodet dhe rregullat disiplinore që lojtari duhet të ndjekë dhe pasojat për shkelje disiplinore) dhe detyrimet dhe përgjegjësitë e klubit (p.sh., sigurimi i pajisjeve, akomodimi, kujdesi shëndetësor);
  - 4.4. **kushtet për zgjidhjen e parakohshme të kontratës;**



- 4.5.** çdo **dispozitë tjetër specifike që palët mund të bien dakord** (p.sh., të drejtat e imazhit, pjesëmarrja në aktivitete promovuese, etj.);
- 4.6.** nëse agjenti i lojtarit me licencë FIBA ka marrë pjesë në negocimin e kontratës, emri dhe numri i licencës duhet figurojë;
- 4.7.** kontrata duhet të jetë e lidhur në përputhje me Statutin dhe aktet tjera normative të FBK-së, FIBA-s dhe rregulloret që vlejné në Republikën e Kosovës.
- 5.** Marrëveshja plotësuese e nënshkruar në mes të lojtarit dhe ekipit të njëjtë e cila nuk është evidentuar në FBK, e me të cilën marrëveshje apo pjesë të saj është përcaktuar angazhimi në sportin e basketbollit, do të ketë fuqi juridike dhe do të pranohet nga trupat e autorizuara të FBK-së dhe do të evidentohet me numër të njëjtë të protokollit si aneks i marrëveshjes paraprake.
- 6.** Lojtari nën moshën 16 vjeç nuk mund të lidhë kontratë profesionale.
- 7.** Kontrata e parë e pavarur mund të nënshkruhet nga klubi dhe lojtari kur lojtari të mbushë 16 vjeç, e cila mund të zgjasë vetëm derisa lojtari të mbushë moshën 18 vjeç.
- 8.** Kontrata e parë profesionale mund të nënshkruhet nga klubi dhe lojtari kur lojtari të mbushë 18 vjeç. Një kontratë e tillë mund të zgjasë nga një deri në maksimum katër vjet, pra deri në fund të sezonit konkurrues në të cilin lojtari mbush 22 vjeç.

## Neni 20 - Llojet e marrëveshjeve

### 1. MARRËVESHJE PËR STËRVITJE DHE PARAQITJE (DERI 14 VJEÇ)

**1.1.** Lojtari deri në moshën 14 vjeçare është i obliguar që me ekipin të cilin e ka zgjedh për stërvitje dhe paraqitje të nënshkruajë marrëveshjen për stërvitje dhe paraqitje.

**1.2.** Kjo marrëveshje nënshkruhet gjatë regjistrimit të parë për ekip dhe futjen e të dhënave në evidencën e FBK-së. Marrëveshja është valide dhe nënshkruhet deri kur lojtari i mbush 14 vjeç.



**1.3.** Me këtë marrëveshje përcaktohet e drejta e paraqitjes së lojtarit në ligë si dhe të drejtat dhe obligimet reciproke në mes të lojtarit dhe ekipit.

**1.4.** Përveç rasteve të cekura në marrëveshje, për lojtarët të cilët me ekipin kanë lidhur marrëveshje për stërvitje dhe paraqitje që paguajnë anëtarësi në çdo kohë janë të lirë që të shkëpusin marrëveshjen për stërvitje dhe paraqitje me ekip dhe në afatet e caktuara kalimtare të kalojnë në ekipin tjetër pa kompensim, në bazë të nenit 13.2. të kësaj Rregulloreje.

**1.5.** Lojtari i cili ka marrëveshje për stërvitje dhe paraqitje (deri në moshën 14 vjeçare), mund të paraqitet edhe për skuadrën me moshë më të madhe për skuadrën e njëjtë, nëse skuadra ka të paraqitur për garat ekip dhe në harmoni me Propozicionet e Garave.

---

## **2. MARRËVESHJA PËR AFTËSIM SPORTIV (14-18 VJEÇ)**

---

**2.1.** Lojtari është i obliguar që marrëveshjen e parë për aftësim sportiv ta nënshkruajë me ekipin anëtarë i të cilit është kur ti mbush 14 vjet, për katër vitet e ardhshme.

**2.2.** Lojtari me moshë më të madhe se 14 vjet, i cili për herë të parë nënshkruan marrëveshjen për aftësim sportiv me ekip, marrëveshjen e nënshkruan të vlefshme përfundimisht me sezonin kur lojtari i mbush 18 vjet.

**2.3.** Në këtë marrëveshje medoemos duhet të ceket se lojtari a paguan apo jo anëtarësinë për kohën kur është në ekip me të cilin nënshkruan marrëveshjen për aftësim sportiv.

**2.4.** Nëse në marrëveshje nuk është cekur se lojtari paguan apo nuk paguan anëtarësi, në procedurën e Komesarit të Garave për Kategori të Reja do të nënkuptohet se lojtari paguan anëtarësi.

---

## **3. MARRËVESHJA E PARË PËR SENIORË**

---

**3.1.** Lojtari është i obliguar që të nënshkruajë marrëveshjen e parë për senior me ekipin anëtar i të cilit ka qenë kur i ka mbushur 18 vjet të vlefshme edhe për katër (4) vjet.



**3.2.** Lojtari me moshë më të madhe se 18 vjet, i cili duhet të nënshkruajë marrëveshjen e parë për senior, marrëveshjen e nënshkruan përfundimisht në sezonin kur lojtari i mbush 22 vjet.

#### **4. MARRËVESHJA PËR SENIORË (MË TË VJETËR SE 22 VJET)**

**4.1.** Marrëveshja për seniorë lidhet për më së paku një (1) edicion garues, nga muaji shtator deri në muajin qershor.

#### **NENI 21 - Përrjashtimet në periudhën kohore të marrëveshjes**

**1.** Për afatin e marrëveshjes së nënshkruar nuk konsiderohet periudha kohore:

- 1.1.** Që lojtari është i dënuar më shumë se tre (3) muaj ndalesë loje, nga ana e organeve të FBK-së;
- 1.2.** Që lojtari është i dënuar më shumë se tre(3) muaj ndalesë loje, nga ana e ekipit dhe e konfirmuar nga ana e organeve të FBK-së;
- 1.3.** Nëse lojtari është paraqitur për skuadrën tjetër që nuk është anëtar i FBK-së, pa lejen e ekipit të vet;
- 1.4.** Vajtja në shkollim jashtë shtetit, me pëlqimin e ekipit;
- 1.5.** Nëse me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor është i dënuar me burgim më shumë se tre (3) muaj.

#### **NENI 22 - Ndërprerja/Shkëputja e marrëveshjes**

**1.** Nëse lojtari dhe ekipi nuk i plotësojnë obligimet e përcaktuara me marrëveshje, secili nga ta mund të kërkojë ndërprerjen e marrëveshjes.

**2.** Kërkesa për ndërprerjen e marrëveshjes të cilës duhet bashkangjitur prova të sakta për ndërprerjen e marrëveshjes i dorëzohet Komisionit të Garave të FBK-së. Së bashku me kërkesën, kërkuuesi duhet të dorëzojë edhe dëshminë mbi pagesën e taksës për ndërprerjen e marrëveshjes në shumë prej 100€ për kategoritë e seniorëve-eve dhe 50€ për konkurrencën e femrave dhe ato të reja.

**3.** Tek kërkesa për ndërprerjen e marrëveshjes lojtari është i obliguar të dorëzojë dëshminë që një kopje e kërkesës për ndërprerjen e marrëveshjes i është dorëzuar ekipit me të cilin është lidhur marrëveshja.



**4.** Komisioni i Garave i FBK-së është i obliguar që në afat prej tri (3) ditësh ta marrë në shqyrtim kërkesën për ndërprerje të marrëveshjes dhe procedurën e shqyrtimit duhet ta kryejë brenda afatit prej 15 ditësh, nga marrja e kërkesës në shqyrtim, por nëse kërkon natyra e procedurës ky afat mund të zgjasë periudhë më të gjatë.

**5.** Komisioni i Garave në bazë të provave që disponon me aktvendim mund:

**5.1.** Të pranojë si të arsyeshme kërkesën për ndërprerjen e marrëveshjes; apo

**5.2.** Të refuzojë si të pabazë kërkesën për ndërprerjen e marrëveshjes.

**6.** Nëse Komisioni i Garave i FBK-së përcakton se kërkesa e kërkuarit është jo e rregullt dhe e paqartë, kërkuarët e obligon që në afat të shkurtër të rregullojë dhe precizojë kërkesën në mënyrë që të mund ta shqyrtojë.

**7.** Nëse kërkesa për ndërprerjen e marrëveshjes nuk është rregulluar dhe precizuar në afatin e dhënë, Komisioni i Garave të njëjtën do ta refuzojë si të parregullt.

**8.** Vendimi i Komisionit të Garave i FBK-së i marr në kërkesë për ndërprerje të marrëveshjes i dorëzohet lojtarit dhe ekipit.

## V. KALIMI PREJ EKIPI NË EKIP

### NENI 23 - Afatet për kalim

**1.** Lojtari me moshë mbi 18 vjeç (senior) mund të kalojë prej ekipi në ekip vetëm në afate kalimtare të cilat caktohen me vendimin e Bordit të FBK-së.

**2.** Afati i paraqitjes së listës (rosterit) për të gjitha kategoritë e seniorëve përcaktohet me vendimin e Bordit të FBK-së.

**3.** Lojtari prej 14 deri në moshën 18 vjeçare (të rinjtë), mund të kalojë prej ekipi në ekip në afatin kalimtar veror dhe dimëror.

**3.1.** Afati veror për lojtarë caktohet me Vendim të Bordit-it të FBK-së.

**3.2.** Afati dimëror për lojtarë të moshës 14-18 vjeçare zgjatë (3-5) ditë dhe caktohet me Vendim të Bordit-it të FBK-së.



**3.3.** Afati për dorëzimin e listës së lojtarëve prej moshës 14 deri në moshën 18 vjeçare, konform dispozitave të kapitullit për regjistrimin e lojtarëve caktohet me vendim të Bordit të FBK-së.

**4.** Lojtari deri në moshën 14 vjeçare mund të kalojë prej ekipi në ekip gjatë kohës së afateve kalimtare verore dhe dimërore.

**4.1.** Afati për dorëzimin e listës së lojtarëve deri në moshën 14 vjeçare, konform dispozitave të kapitullit për regjistrimin e lojtarëve caktohet me vendim të Bordit të FBK-së.

## **NENI 24 - Dispozita tjera rreth kalimit prej ekipi në ekip**

**1.** Lojtari i cili ka të lidhur marrëveshjen me ekip dhe nuk gjendet në listën paraqitëse të ekipit për edicionin e ardhshëm garues, nëse ekipi është përjashtuar nga garat apo ekipi është larguar nga garat për shkaqe të ndryshme, të drejtën për të kaluar prej ekipi në ekip mund ta realizojë më së voni një javë pas përfundimit të afatit të rregullt kalimtar.

**2.** Lojtari i regjistruar për ekip të seniorëve, i cili e ka ndërprerë marrëveshjen me ekip, mund të realizojë vetëm një kalim në ekip tjetër, deri në ditën e fundit të afatit kalimtar dimëror.

**3.** Nuk konsiderohet si kalim prej klubi në klub, nëse lojtari nuk është paraqitur për ekip, për atë që ekipi ka qenë i përjashtuar, është larguar nga garat, apo për shkaqe të ndryshme nuk i ka filluar garat në edicionin e ri. Në këtë rast, lojtari është i lirë që të nënshkruajë për çfarëdo ekipi tjetër dhe të realizojë të drejtën të kalojë në ekip tjetër, në harmoni me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

**4.** Nuk konsiderohet kalimi prej klubi në klub, nëse lojtari ka të lidhur marrëveshjen me ekip dhe nuk gjendet në listën paraqitëse të klubit para fillimit të edicionit të ri garues (për atë që marrëveshja në mes të lojtarit dhe ekipit pushon të vlejë), nënshkruan marrëveshje me ekipin tjetër për edicionin vijues. Në këtë rast, lojtari është i lirë të nënshkruajë marrëveshje me çfarëdo ekipi tjetër dhe me këtë të realizojë të drejtën për kalim edhe në një ekip, në harmoni me dispozitat e kësaj rregulloreje.

**5.** Lojtari nuk mund të paraqitet në të njëjtën xhiro për dy skuadra.



**6.** Për lojtarë ndërkombëtarë (të huaj) vlejné dispozitat e kapitullit IX të kësaj Rregulloreje.

**7.** Lojtarët e ligave të kategorive të reja të FBK-së, të cilët do të largohen nga listat paraqitëse të ekipit marrin statusin e lojtarit të lirë me të drejtë kalimi në ekip tjetër pa dëmshpërblim, në harmoni me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

## **NENI 25 - E drejta e kalimit**

**1.** Të drejtë kalimi prej një skuadre në skuadrën tjetër ka:

**1.1.** Lojtari të cilit i ka skaduar marrëveshja dhe nuk dëshiron të nënshkruajë marrëveshje të re me skuadrën e deritanishme;

**1.2.** Lojtari i cili e ndërprente marrëveshjen me ekip;

**1.3.** Lojtari të cilit me aktvendim të plotfuqishëm të organit të autorizuar të FBK-së i është ndërprerë marrëveshja me skuadrën e deritanishme;

**1.4.** Lojtari i cili nuk gjendet në listën paraqitëse (rosterin) të ekipit për edicionin (sezonin) e ardhshëm;

**1.5.** Lojtari i ekipit që është përjashtuar nga garat apo i ka lëshuar garat për shkaqe të ndryshme gjatë edicionit aktual mund të kalojë prej klubi në klub në afat prej 10 ditësh nga dita e tërheqjes nga garat apo nga dita e përjashtimit të ekipit nga garat e mëtutjeshme;

**1.6.** Lojtari deri në moshën 14 vjeçare, pa dëmshpërblim, vetëm nëse ajo nuk është rregulluar me marrëveshjen për stërvitje dhe paraqitje;

**1.7.** Lojtari prej moshës 14 deri në moshën 18 vjeçare, i cili ka marrëveshjen për aftësim sportiv me ekipin e caktuar, ka të drejtë kalimi prej ekipi në ekip në vend, nën këto kushte:

**1.7.1.** Nëse lojtari ka paguar në ekip për aftësimin e tij sportiv dhe nëse për këtë dëshmon me dokumentacionin valid, ka të drejtë kalimi në ekipin tjetër në vend, pa dëmshpërblim dhe atë vetëm një herë gjatë një edicioni garues.



**1.7.2.** Nëse lojtari nuk i ka paguar ekipit për aftësimin e tij sportiv, ka të drejtë kalimi në ekipin tjetër me dëmshpërblim. Nëse me marrëveshje reciproke për aftësim sportiv nuk është cekur shuma për dëmshpërblim, atëherë do të paguhet sipas këtyre kritereve:

- 1,000 EUR për çdo edicion të paraqitur për ekip (shtator-Qershor) në ligat e grup-moshave të reja;
- 1,000 EUR për çdo edicion të paraqitur për ekip në ligat e grup-moshave të reja, nëse është i licencuar nga FIBA Evropa për përzgjedhjet e reja të FBK-së, prej të cilës shumë 75% paguhet në llogarinë e klubit dhe 25% në llogarinë e FBK-së. Gjatë llogaritjes së dëmshpërblimit merret parasysh çdo edicion në të cilin ka qenë lojtari në përzgjedhje.
- Nëse bëhet fjalë për transfer ndërkombëtar, shumat e lartpërmendura dyfishohen, gjegjësisht shumëzohen me dy (2);
- Llogaritjen e lartësisë së dëmshpërblimit e bënë Komisioni i Garave i FBK-së, dëmshpërblimi llogaritet për tërë edicionin (gjithsej 10 muaj).
- Në rast që lojtari ka paguar anëtarësinë mujore në ekip, dëmshpërblimi llogaritet vetëm për periudhën për të cilën nuk ka dëshmi për pagesë të anëtarësisë, ku shuma e paraparë për kompensim pjesëtohet për dhjetë (10) muaj dhe shuma e fituar shumëzohet me numrin e muajve për të cilat nuk ka dëshmi për pagesën e anëtarësisë.
- Nëse lojtari, i cili e ka fituar të drejtën e lojtarit të përzgjedhjes, gjegjësisht është licencuar nga ana e FIBA-s për ndonjë përzgjedhje, kërkon që të ndërpres marrëveshjen gjatë rrjedhjes së edicionit të garave, llogaritja e dëmshpërblimit do të bëhet në bazë të dispozitave të kësaj Rregullore;
- Lojtari ka të drejtën e fituar të lojtarit të përzgjedhur të cilën mund ta humb nëse pas përfundimit të edicionit aktual në





listën e lojtarëve të licencuar nga FIBA për çfarëdo përzgjedhje nacionale.

- Dëshmia për pagesën e kryer për dëmshpërblimin e caktuar dorëzohet në zyrën e FBK-së.
- Ekipi i cili duhet të dëmshpërblehet, mund të heq dorë nga dëmshpërblimi me nënshkrimin dhe vulosjen e deklaratës nga personi i autorizuar i ekipit, dhe e njëjta duhet të dorëzohet në zyrën e FBK-së.

## VI. FUZIONIMI (BASHKIMI) I EKIPEVE

### NENI 26 - Fuzionimi

- 1.** Fuzionimi (bashkimi) i ekipeve në garat e FBK-së është fuzionimi i dy e më tepër ekipeve me marrëveshje për fuzionim në formë të shkruar, për realizimin e interesave të tyre dhe zhvillimin e sportit të basketbollit.
- 2.** Gjatë kërkesës për fuzionim, ekipet janë të obliguara që në afatet e caktuara me këtë nen, t'i dorëzojnë Komisionit të Garave, Marrëveshjen origjinale për fuzionim me numër të mjaftuar të kopjeve (nga një për çdo ekip pjesëmarrës në fuzionim dhe një për FBK). Marrëveshja do të evidentohet në regjistrin e FBK-së ku dëshmohet pagesa e taksës administrative në shumë prej 500€.
- 3.** Komisioni i Garave i FBK-së është i obliguar që në afat prej 3 (tri) ditëve nga dita e marrjes së kërkesës të marrë lëndën në procedurë dhe e njëjta duhet të përfundojë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së lëndës në procedurë, përveç nëse natyra kërkon periudhë më të gjatë.
- 4.** Marrëveshja për fuzionim në mes të dy apo më tepër ekipeve të FBK-së merr efekt ligjor në momentin kur e njëjta lejohet me aktvendimin e Komisionit të Garave të FBK-së.
- 5.** Nga momenti i fuzionimit të lejuar me aktvendimin e Komisionit të Garave, ekipet e fuzionuara fillojnë të realizojnë të drejtat dhe obligimet e tyre në FBK si një ekip, gjegjësisht në harmoni me marrëveshjen reciproke për fuzionim. Nëpërmjet përfaqësuesit dhe nënshkruesit të autorizuar zgjidhet emri i ekipit, vula, llogaria bankare në Republikën e Kosovës,



kontaktet, selia dhe adresa postare elektronike e ekipit dhe i njëjti në të ardhmen do të jetë përfaqësues pranë FBK-së.

**6.** Ekipi, përfaqësues i ekipeve të fuzionuara, në bazë të marrëveshjes për fuzionim, vazhdon të bëjë gara në një nga ligat e seniorëve, derisa klubet tjera, pjesëmarrës në fuzionim, mund të vazhdojnë veç e veç të garojnë në ligat e grupmoshave të reja të FBK-së si subjekte të veçanta ligjore. Ekipet pjesëmarrëse në fuzionim nuk kanë të drejtë të garojnë në ligat e seniorëve derisa marrëveshja për fuzionim është në fuqi.

**7.** Në marrëveshjen për fuzionim duhet të jetë dispozita për mënyrën e ndarjes eventuale, ku në mënyrë precize duhet të ceket se cilat nga ekipet dhe me çfarë statusi do të vazhdojnë pas ndarjes së krijuar, përgjegjësia financiare e subjekteve - të ardhurat nga anëtarësia, nga marketingu i ligave, dhuratat për plasman në ligat e FBK-së, etj, si dhe shpenzimet për gara, kootizime, dënime, licencime dhe shpenzime tjera në harmoni me Propozicione të Garave dhe akteve tjera, si dhe në bazë të vendimeve të trupave të autorizuar të FBK-së.

**8.** Fuzionimi i ekipeve mund të ketë veprim ligjor në sistemin e garave të FBK-së nëse kryhet më së voni 24 orë para paraqitjes së listës paraqitëse për garat e FBK-së për edicionin e ardhshëm të garave.

**9.** Fuzionimi i ekipeve pas këtij afati mund të ketë veprim ligjor në sistemin e garave të FBK-së nga edicioni tjetër.

## VII. PARAQITJA JASHTË SHETIT

### NENI 27 - E drejta e paraqitjes jashtë shtetit

Lojtari fiton të drejtën e paraqitjes jashtë vendit pas marrjes së pëlqimit nga ekipi dhe lëshimit të fletë lëshimit (LoC) nga ana e FBK-së.

### NENI 28 - Kërkesa

**1.** Kërkesa për dhënien e pëlqimit për paraqitje jashtë vendit i dorëzohet Komisionit të Garave nëpërmjet zyrës së FBK-së, ku dokumentacioni komplet duhet të përmbajë:



- 1.1.** Kërkesa nga Federata Nazionale të cilës i përket ekipi, e adresuar në FBK;
- 1.2.** Pëlqimi i ekipit për paraqitje jashtë vendit, nëse marrëveshja është valide;
- 1.3.** Pagesa e taksës administrative për fletëçregjistrim (LoC).

## **NENI 29 - Transferi ndërkombëtar i lojtarëve nën 18 vjeç**

- 1.** Transferi ndërkombëtar i lojtarëve deri në moshën 18 vjeçare nuk është i lejuar, përveç në raste special ku me pëlqimin e ekipit në formë të shkruar, personi i autorizuar i FBK-së lëshon Fletë lëshimin (LoC) për të luajtur jashtë shtetit, në bazë të dispozitave të përcaktuara me aktet e FIBA-s dhe me këtë Rregullore për regjistrim dhe kalim në FBK.
- 2.** Për lojtarët më të vjetër se 18 vjet, LoC për të luajtur jashtë vendit e lëshon personi i autorizuar në bazë të dispozitave të përcaktuara me aktet e FIBA dhe me këtë Rregullore për regjistrim dhe kalim në FBK.
- 3.** FBK e lëshon LoC me kusht që lojtari i cili shkon jashtë shtetit të nënshkruajë deklaratën se në çdo kohë do të jetë në disponim për ndeshjet dhe përgatitjet e Përfaqësuesëve të Kosovës.
- 4.** Vendimin për të luajtur jashtë vendit e merr Komisioni i Garave brenda afateve të përcaktuara nga FIBA (7-10 ditë) nga dita e pranimit të dokumentacionit komplet.

## **VIII. KTHIMI I LOJTARIT NGA JASHTË**

### **NENI 30 - Kthimi i lojtarit vendor në klub vendas**

- 1.** Lojtari vendor i cili merr pëlqimin për të luajtur jashtë vendit gjatë edicioni aktual mund të kthehet dhe të paraqitet në kampionatin vendor me dokumentacionin komplet.
- 2.** Lojtari vendor i cili ka realizuar një transfer gjatë edicionit aktual, e pastaj realizon edhe transfer ndërkombëtar, mund të regjistrohet si lojtar i kthyer nga jashtë në klub tjetër vetëm me pëlqimin e ekipit nga i cili ka marrë pëlqimin fillestar për të luajtur jashtë vendit (klubi fillestar).



**3.** Lojtari mund të kthehet dhe të paraqitet në kampionatin vendor në ekipin me të cilin nënshkruan marrëveshjen, vetëm nëse ka realizuar angazhman në ndonjë ekip jashtë vendit dhe nëse ka luajtur në më së paku 1 muaj të plotë dhe katër (4) ndeshje kampionale apo të Kupës për ekipin jashtë vendit dhe ka pëlqimin nga klubi fillestar.

**4.** Regjistrimi i lojtarit të kthyer nga jashtë është i mundur deri 72 orë para zhvillimit të xhiros së XXII për ekipet e Superligës së Meshkujve (kur edhe skadon afati edhe për regjistrimin e lojtarëve të huaj) dhe 72 orë para zhvillimit të xhiros së XVI të Superliga e Femrave (kur edhe skadon afati edhe për regjistrimin e lojtareve të huaja).

## IX. PARAQITJA E LOJTARËVE NDËRKOMBËTARË (TË HUAJ)

### NENI 31 - Paraqitja e lojtarëve të huaj

- 1.** Për ndeshjet kampionale dhe të Kupës çdo ekip pjesëmarrës ka të drejtë të regjistrojë lojtarë ndërkombëtarë (të huaj), në bazë të dispozitave të përcaktuara me këtë Rregullore.
- 2.** Ekipi ka të drejtë regjistrimi të lojtarit ndërkombëtar (të huaj). Kërkesën për regjistrim me dokumentacionin komplet duhet ta dorëzojë në FBK më së voni 48 orë para fillimit të ndeshjes kampionale apo të Kupës.
- 3.** Numri i paraqitjeve të lojtarëve ndërkombëtarë për të gjitha ligat dhe angazhimi i tyre në një ndeshje përcaktohet me Propozicione të Garave.
- 4.** Transferi i lojtarëve të huaj mes ekipeve të Kosovës është i mundshëm vetëm gjatë afatit kalimtar, nën kushte identike si lojtarët vendorë.
- 5.** Lojtari ndërkombëtar deri në moshën 18 vjeçare i cili ka vendbanim në Republikën e Kosovës në bazë të shkollimit apo punës së përkohshme, mund të regjistrohet si lojtar vendor dhe të paraqitet për grupmosha të reja, me leje të Komesarit të Garave për Kategori të Reja në FBK.

### NENI 32 - Lojtari i natyralizuar

- 1.** Për qëllim të kësaj Rregullore, bëhet dallimi mes lojtarit të natyralizuar përmes:



**1.1.** natyralizimit me Dekret të Presidentit për interes të veçantë të Republikës së Kosovës;

**1.2.** natyralizimit me mënyra të tjera (natyralizimi i bashkëshortit, natyralizimi i fëmijës së mitur të personit të natyralizuar, natyralizimi i pjesëtarit të diasporës të Republikës së Kosovës, natyralizimi i personit që e ka humbur shtetësinë e Republikën e Kosovës).

**2.** Lojtari-ja i/e natyralizuar (sipas alinesë 1.1. apo 1.2. si më lart) ka të drejtë që për ekip të regjistrohet si lojtar vendor, nëse klubi njofton për ndryshim të statusit të lojtarit deri në ditën e fundit të afatit kalimtar dimëror. Krahas njoftimit, duhet bashkëngjitur edhe dokumentet përkatëse (dokumentet valide identifikuese, pasaporta, dhe dekreti i Presidentit në rast të natyralizimit me Dekret të Presidentit për interes të veçantë të Republikës së Kosovës). Në rast se klubi nuk paraqet këtë njoftim, lojtari mban statusin e lojtarit të huaj deri në fund të edicionit garues.

**3.** Lojtarët e natyralizuar kanë statusin e lojtarit vendor deri në një vendim tjetër.

**4.** Çdo skuadër ka të drejtën të paraqes vetëm 1 (një) lojtar të natyralizuar me Dekret të Presidentit për interes të veçantë të Republikës së Kosovës.

## X. PARAQITJA E LOJTARËVE

### NENI 33 - E drejta e paraqitjes në ndeshje

Në ndeshjet e të gjitha ligave si dhe ndeshjet për Kupë, lojtarët mund të paraqiten vetëm nëse posedojnë licencën përkatëse.

### NENI 34 - Licenca e dyfishtë

**1.** Lojtari deri në moshën 21 vjeçare, i cili ka të drejtë paraqitjeje në Superligë, gjegjësisht në Ligën e Parë, mund të paraqitet për ekip tjetër në nivel më të ulët të garave, me lëshimin e licencës së dyfishtë, në bazë të pëlqimit me shkrim të ekipit për të cilin është i regjistruar lojtari.

**2.** Nëse ekipi i cili e jep pëlqimin për licencim të dyfishtë i ka ekipet e reja, të gjithë lojtarët të cilët kanë të drejtë paraqitjeje për këtë ekip në ligat për të rinj, pa marr parasysh se a gjenden në listën e seniorëve, mund të



paraqiten me licencë të dyfishtë për skuadrën tjetër të seniorëve në nivel më të ultë.

3. Një ekip mund të ketë më së shumti katër (4) lojtarë me licencë të dyfishtë gjatë një edicioni garues.
4. Licenca e dyfishtë mund të lëshohet 24 orë para fillimit të pjesës së parë apo të dytë të kampionatit.
5. Lojtari me licencë të dyfishtë nuk mund të paraqitet për të luajtur për dy ekipe në ditën e njëjtë të zhvillimit të ndeshjeve.

### **NENI 35 - Paraqitja për klub tjetër**

Lojtari mund të paraqitet për ekip tjetër për ndeshje miqësore apo ndeshje zyrtare ndërkombëtare, vetëm me pëlqimin e ekipit për të cilin është i regjistruar lojtari për edicionin garues.

### **NENI 36 - Huazimi i lojtarëve**

1. Një klub mund të huazojë një lojtar të një klubi tjetër për një sezon konkurrues, me ç' rast lojtari nuk ka më të drejtën të paraqitet për klubin në të cilin është regjistruar, mirëpo fiton të drejtën për të luajtur për klubin në të cilin është huazuar.
2. Huazimi është i mundur vetëm përmes marrëveshjes me shkrim për huazim dhe mund të arrihet vetëm para përfundimit të afatit kalimtar.
3. Në rast të huazimit të një lojtari nën moshën 16 vjeç, duhet bashkëngjitet pëlqimi me nënshkrim të prindit ose përfaqësuesit ligjor.
4. Një klub mund të ketë maksimum 2 lojtarë të huazuar në konkurrencën e meshkujve dhe 5 lojtare të huazuara në konkurrencën e femrave.

## **XI. REGJISTRIMI DHE LICENCIMI I TRAJNERËVE**

### **NENI 37**

1. Regjistrimin e trajnerëve të basketbollit e bënë Komisioni i Garave në FBK.



- 2.** Trajnerët e basketbollit mund ta kryejnë detyrën e tyre nëse posedojnë licencën e trajnerëve.
- 3.** Licencën për kryerjen e detyrës së trajnerit e lëshon Shoqata e Trajnerëve, në bazë të kriterëve të përcaktuar.
- 4.** Marrëveshjet për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve reciproke në mes të trajnerit dhe ekipit evidentohet në FBK.
- 5.** Marrëveshjet për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve reciproke në mes të trajnerit dhe ekipit, të cilat nuk janë evidentuar në FBK nuk kanë asnjë veprim ligjor.
- 6.** Marrëveshja për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve duhet në mënyrë të detajuar të përshkruajë të drejtat dhe obligimet e trajnerit dhe ekipit. Trajneri ka të drejtë, nëse nuk i plotësohen kërkesat financiare sipas marrëveshjes, të kërkojë mbrojtjen e ligjshmërisë dhe Komisioni i Garave nuk mund t'i lëshojë ekipit licencë për trajner të ri, derisa ekipi nuk dëshmon se i ka përmbushur obligimet financiare. Trajneri ka të drejtë të tërhiqet nga pretendimet e porealizuara dhe me njoftim në formë shkrimi të njoftojë FBK-në.
- 7.** Për kryerjen e detyrës së trajnerit, ekipi është i obliguar të paguajë taksën në shumën e caktuar me vendim të posaçëm të Bordit të FBK-së.

## XII. E DREJTA PËR ANKESË DHE KËRKESA PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË

### NENI 38

- 1.** Kundër aktvendimit të Komisionit të Garave të FBK-së, të publikuar në faqen zyrtare të FBK-së dhe kundër të gjitha vendimeve të tij, palët në afat prej 3 ditësh nga dita e publikimit apo nga dita e pranimit të vendimit, kanë të drejtë anekese nëpërmjet Komisionit të Garave tek Komisioni i Arbitrazhit i FBK-së (si shkallë e dytë).
- 2.** Ankesa e cila është dorëzuar pas afatit të caktuar për ankesë do të refuzohet dhe nuk do të shqyrtohet.



- 3.** Nëse kundër vendimit të Komisionit të Garave të FBK-së, një nga palët ka paraqit ankesë, regjistrimi dhe paraqitja e lojtarit nuk është i lejuar deri në vendimin e marr nga Komisioni i Arbitrazhit i FBK-së.
- 4.** Komisioni i Arbitrazhit është i obliguar që në afat prej shtatë (7) ditësh të marrë ankesën në shqyrtim.
- 5.** Kundër vendimit të plotfuqishëm të Komisionit të Garave, palët kanë të drejtë të kërkojnë mbrojtjen e ligjshmërisë e cila dorëzohet nëpërmjet të Komisionit të Garave tek Bordit i FBK-së.
- 6.** Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk ka efekt pezullues në vendimin e plotfuqishëm të Komisionit të Garave dhe vendimi i marr sipas kërkesës nuk ka efekt retroaktiv në lidhje me ndeshjet të cilat janë zhvilluar deri në marrjen e saj.
- 7.** FBK nuk merr përgjegjësi për kurrfarë kompensimi të dëmeve të shkaktuara për anulimin e vendimit të shkallës së parë.
- 8.** Nëse palët nuk kanë shfrytëzuar të drejtën e ankesës, të njëjtit u kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit të Komisionit të Garave të FBK-së.

## XIII. DORËZIMI

### NENI 39

- 1.** Korrespondencën me FBK-në dhe komisionet e FBK-së palët e kryejnë nëpërmjet zyrës ekzekutive të FBK-së.
- 2.** Dorëzimi i shkresave në FBK kryhet drejtpërdrejtë në zyrën e FBK-së, me anë të postës dhe me anë të postës elektronike.
- 3.** Çdo shkresë e dorëzuar nga personi juridik në FBK duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur nga personi i autorizuar apo të nëpërmjet të autorizuesit me autorizimin e bërë nga noteri.
- 4.** Çdo shkresë e dorëzuar nga personi fizik në FBK, duhet të dorëzohet në mënyrë fizike duke bashkangjitur dokumentin për identifikim personal, apo nëpërmjet autorizuesit me autorizimin e bërë nga noteri.
- 5.** Data e pranimit të shkresës konsiderohet dita kur shkresa është dorëzuar drejtpërdrejtë, postës dhe postës elektronike.





**6.** Zyra Administrative e FBK-së, shkresat e dorëzuara i adreson në palët e cekura në adresë.

## XIV. AFATET

### NENI 40

1. Afate nënkuptohen ditët, muajt dhe vitet.
2. Nëse afatet janë caktuar me ditë, në afat nuk llogaritet dita e dorëzimit të shkresës.
3. Brenda afatit të përcaktuar, do të konsiderohet dita e parë e ardhshme.
4. Në afat të përcaktuar nuk llogaritet dita e diel dhe festat shtetërore dhe afati kalon pas kalimit të ditës së parë të ardhshme punuese.

## XV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALUESE

### NENI 41

1. Të gjitha çështjet tjera të cilat nuk janë paraparë me këtë rregullore dhe Rregullat zyrtare të basketbollit, do të përcaktohen me Propozicionet e Garave, aktet normative të FBK-së dhe FIBA.
2. Ndërrimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje miratohen sipas procedurës së njëjtë të aprovimit të tyre.
3. Interpretimin e kësaj Rregulloreje e jep Bordi i FBK-së.
4. Kjo Rregullore hynë në fuqi me miratimin e saj nga ana e Bordit të FBK-së.

Miratoi Bordi i FBK-së më 09.08.2024 në Prishtinë.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Kryetar

Arben FETAHU

